



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Letërsi e gjuhës B1

Ngarkesa: 4 kredite, 20 leksione dhe 20 seminare)
Viti / Semestri : Viti II, semestri i II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmes historisë letrare dhe fragmenteve të veprave të zgjedhura me kujdes, kjo lëndë paraqet një panoramë të letërsisë franceze nga zanafillat deri në shekullin e XVIII-të. Trajtimi kronologjik i letërsisë ndër shekuj është zgjedhur enkas, si e vetmja mënyrë për t’u dhënë studentëve njohuri të domosdoshme mbi fillesat dhe evolucionin e letërsisë frënge. Nga Mesjeta e deri në shekullin e Dritave, çdo shkrimtar paraqitet si pjesë e epokës në të cilën ka jetuar dhe krijuar. Kështu, krijimi i një vepre letrare do mund të analizohet si pjesë e një konteksti historik e sociologjik. Çdo shekull përcillet si një paraqitje njëherazi e qartë dhe sintetike, duke i ofruar studentit elemente të nevojshme për kuptimin e një epoke të caktuar : tablo historike dhe shoqërore, rryma të mëdha të mendimit intelektual, fetar dhe filozofik, si dhe rryma letrare. Tekstet janë zgjedhur në atë mënyrë sa t’i japin secilës prej veprave të studiuara, një imazh sa më të plotë të mundshëm, duke mos u imponuar studentëve një nivel të vetëm leximi. Tekstet e punuara në klasë (fragmente veprash) plotësojnë kuadrin teorik, nxisin hulumtimin dhe i pajisin studentët me sensin analitik dhe kritik të veprës.

Këto orë mësimore janë konceptuar, jo vetëm për t’u dhënë studentëve të vitit të dytë bachelor, elementet e nevojshme për njohjen dhe kuptimin e letërsisë franceze, por mbitëgjitha për t’u ngjallur dëshirën e leximit të veprave të plota.